

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN, gjyqtari Refki Piraj, me procesmbajtësen Halime Nixha, sekretare juridike e kësaj gjykate, në lëndën penale kundër te pandehurit B. S. nga fsh. K. Komuna e M. , i akuzuar sipas aktakuzës se PSH ne Prizren PP/II.nr.3760/15 të datës 24.03.2016, për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 te te KP-së, në prezencën e të akuzuarit, prokurorit te shtetit Fatos Ajvazi, më dt.25.04.2017, muar dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri :

B. S., i lindur me *data e lindjes...* ne fsh. K. Komuna e M. , ku edhe banon, nga i ati M. e ëma Z. e lind. M., ka te kryer shkollën e mesme i pa martuar minator i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar - shtetas i R te Kosovës

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 30.10.2015 rreth orës 23,22 min, ne piken Kufitare _ V. Komuna e P., duke hyre nga Republika e Shqipërisë ne republikën e Kosovës, me dije përdor dokumentin e falsifikuar apo te ndryshuar si origjinal, me qlelim te shfrytëzimit te atij dokumenti si origjinal, ne atë mënyrë qe patrulla e policisë e kishin ndaluar, jgate kontrollit tek ai has: Letrnjoftimin e republikës se Kosoves, me nr. serik :....., i cili pas ekspertizes se bere nga ana e Sektorit per Ekspertim te Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve, me nr....., te datës 24.11.2015, del se letërnjoftimi është tërësisht te falsifikuar.

-keso dore ka kryer vepren penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 -1 te KP.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 3, 4, 41, 43, 46 te KP te pandehurit i shqipton :

DENIM ME GJOBË

Ne shume prej 260 (dyqindegjashtedhete) euro, të cilin dënim do ta paguaj ne xhironlogarinë e kesaj gjykate, nga dita e plotfuqishmërisë se ketij aktgjykimi , e po qese dënimi me te holla nuk mund te paguhet nga ana e te akuzuarit ne afatin e sipërpërmendur, i njëjti do te zëvendësohet me denim burgu duke llogarite 20 euro , nje dite burg qe don te thote 13 dite burg.

Te akuzuarit i shqiptohet dënimi plotësues konfiskimi letërnjoftimit te falsifikuar me nr...

Obligohet I pandehuri qe ti paguajnë te gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato bëhen ne baze te llogarisë se gjykatës, kurse ne emër te te paushallit gjyqësor te paguajnë shumen prej 40 euro, e te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nen kërcenim te ekzekutimit te dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren , i ka paraqitur kësaj gjykate aktakuzën PP/II.nr.3760/15 të datës 24.03.2016 kundër të pandehurit B. S. nga fsh.K. Komuna e M...., për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 të KP-së.

I akuzuari B. S. ne shqyrtimin fillestar , në tërësi ka pranuar veprën penale e cila i vëhet në barrë sipas aktakuzës.

Gjyqtari gjykues, përcaktoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, i njëjti është i vullnetshëm dhe se pranimi mbështetet ne faktet e çështjes që përmban aktakuza , dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike.

Gjyqtari gjykues, pas marrjes së mendimit edhe nga ana e Prokurorit të Shtetit pranimin e fajësisë e ka aprovuar .

Gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit, plotësohen të gjitha elementet qenësore te veprës penale te shantazhit nga neni 341/1 te KP dhe veprës penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 /3-1/3.1 – 31 te KP së, prandaj dhe ia shqiptoi dënimin unik me kusht duke qenë i bindur se me këtë lloj dënimi do te arrihet qëllimi i të njëjtit.

Gjykata çmoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese, secilën në veçanti dhe lidhshmëri në mes tyre me të gjitha rrethanat tjera të cilat ishin me ndikim në përcaktimin dhe qëllimin e dënimit.

Si rrethanë rënduese gjykata kishte parasysh intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, kurse në rrethanat lehtësuese pranimin e fajit, shprehjen e pendimit dhe rrethanat familjare të pandehurit si dhe sjelljen e tij korrekte para gjykatës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë ne kuptim te nenit 450 dhe 452 te KPPK-se.

Më sa u tha më lartë u vendos si ne shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN P.nr.662/16 të dt.25.04.2017

Procesmbajtësja:
Halime Nixha

Gjyqtari:
Refki Piraj

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, mund të ushtrohet ankes, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi, Gjykatës së Apelit ne Prishtine, e nëpërmjet të kesaj gjykate.